

Shëndetësia në gatishmëri, mbi 26 mijë qytetarë kanë marrë shërbim në qendrat verore



Mbi 26 mijë turistë dhe pushues që kanë marrë shërbim në 30 qendrat shëndetësore verore të hapura enkas në zonat turistike. Përveç 30 qendrave shëndetësore verore që ofrojnë shërbime, vizita, konsulta, mjekime, Urgjenca Kombëtare është po ashtu në gatishmëri të plotë për t'ju përgjigjur të gjitha thirrjeve për ndihmë mjekësore në numrin unik 127.



MASAT PËR PËRBALLIMIN E TË NXEHTIT, 9 NJËSI TË LËVIZSHME PËR ASISTENCË MJEKËSORE

Për zbatimin e planit të masave kundër valës së të nxehtit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në koordinim me ISHP, OSHKSH, QKUM dhe Njësinë Mjekësore të Ushtrisë, vendosën në gatishmëri 9 autoambulanca në zonat me fluksin më të lartë në qytete, për ardhjen në ndihmë të rasteve urgjente.

NIS INVESTIMI NË POLIKLINIKËN E SHKODRËS

Brenda vitit përfundon rehabilitimi i Poliklinikës së Specialiteteve në Spitalin Rajonal Shkodër, e cila do të ofrojë më shumë shërbime ambulatorore për qytetarët, sipas standardeve evropiane. Rikonstruksioni i Poliklinikës së Specialiteteve është një investim i qeverisë shqiptare, që do të mundësojë organizim të ri me 13 kabinate mjekësore, të cilat do t'ju shërbejnë rreth 50 mijë qytetarëve. Gjithashtu programi i rehabilitimit të strukturave të kujdesit shëndetësor përfshin edhe modernizimin e Poliklinikës së Elbasanit, Durrësit dhe Dibrës.



ZGJEROHEN SHËRBITIMET NË QENDRAT SHËNDETËSORE

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu ka bërë me dije zgjerimin e shërbimeve në qendrat shëndetësore që ofrohen për qytetarët afër vendbanimit. Me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofrimit të kujdesit parësor si dhe krijimin e ekipeve multidisciplinare gjithëpërfshirëse, këto qendra do të plotësohen edhe me dy specialitete të tjera: logoped dhe fizioterapeut.

PROGRAMI I KONTROLLIT MJEKËSOR BAZË

Në Forumin Shkencor për Programin e Kontrollit Mjekësor Bazë dhe impaktin e tij në parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme, me pjesëmarrjen e ekspertëve të ISHP, mjekë të QSUT dhe përfaqësues të Universitetit të Mjekësisë, u diskutua për përfitimet shëndetësore dhe ekonomike që ka sjellë Programi i Kontrollit Mjekësor Bazë. Sipas të dhënave të fundit, Programi i Kontrollit Bazë Shëndetësor po e ndihmon Shqipërinë të arrijë objektivat lidhur me uljen e vdekshmërisë së parakohshme nga sëmundjet jo të transmetueshme.

